

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rustem Begolli, me zyrtaren ligjore Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehurve F.Sh., A.K.dhe E.B., për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4570/2017, të dt:07.08.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP.II.nr.4570/2017, të dt:07.08.2018, më **01.10.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4570/2017, të dt:07.08.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurit:

F.SH.: nga i ati S.1, i lindur me datë ..., në fshatin S.2, tani me vendbanim në Rr."A.J.", ..., në V., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

A.K.: nga i ati F., i lindur me datë ..., me vendbanim në Rr."B.B.", nr.... në K., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

E.B.: nga i ati S.3, i lindur me datë ..., me vendbanim në fshatin M., Komuna F., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

S e p s e: Me datë 27.03.2017, të pandehurit me qëllim të marrjes së vizës për biznes në ambasadën Sllovake, kanë paraqitur dokumente të falsifikuara me rastin e aplikimit për viza kanë paraqitur vërtetime si punëtor të punësuar te firma "A.", nga Ll., ku pronari biznesi është L.I., dhe se gjeja ata udhëtojnë me qëllim të pjesëmarrjes në panair, po ashtu edhe autorizimi i bërë tek noteri ku gjeja L.I. autorizon F.Sh. për përdorimin e veturës Passat me targa të regjistrimit ..., ngjyrë hirit meta;ike me numër të shasisë WVWZZZ6GZLV557886.

Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurve F.Sh., A.K.dhe E.B. i'u shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri: **F.Sh.** dënohet me gjobë në shumë prej **500.00 € (pesë qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri: **A.K.** dënohet me gjobë në shumë prej **500.00 € (pesë qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri: **E.B.** dënohet me gjobë në shumë prej **500.00 € (pesë qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohen të pandehurit që t'i paguajnë shpenzimet procedurale dhe atë për paushallin gjyqësor secili (**veç e veç**) në shumë prej **20€**, ndërsa për ekspertizen mjeko – ligjore në mënyrë (**solidare**) në shumë prej **20€**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: **L.I.**, me vendbanim në fshatin Ll., Komuna F., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP.II.nr.4570/2017, të dt:07.08.2018, ka akuzuar, F.Sh., A.K.dhe E.B., se kanë kryer veprën penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPRK-së, njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se të pandehurit kanë kryer veprën penale, për të cilën akuzohen.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2017-KE-130 të datës 15.05.2017, deklaratat e të pandehurve e e dhënë në procedurën paraprake, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se të pandehurit F.Sh., A.K.dhe E.B., janë penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjteve i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.3465/2018 të dt. 01.10.2018

**Zyrtare ligjore,
Sanije Troshupa**

**G j y q t a r i
Rrustem Begolli**

KËSHILLA JURIDIKE: Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.